

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, gjyqtarja Suzana Çerkini me sekretaren juridike Gylten Dubovci, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Teki Bokshi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 e ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195 dhe nenit 198 parag.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79 (LK), me datë **04.04.2013** merr këtë:

AKTVE N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse ndaj **Teki Haki Bokshi**, i lindur më 20.10.1949 në Gjakovë, ku edhe jeton me vendbanim në rrugën “Shirine Brovina” nr.36, me shkollim superior, me profesion avokat, Anëtar i Jashtëm në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, për kundërvajtje nga neni nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 e ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtar, Pezullimi bëhet komfor nenit 198 para.1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtje, në mungesë të provave me çka do të dëshmohej se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur. Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet palëve në procedure të kundërvajtjes.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate Kërkesën 01-2160/2012 me datë 27.06.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë nuk ka bërë deklarin e rregullt të pasurisë deri më datë 31.03.2012.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja me konkluzion filloi procedurën kundërvajtëse, ftoi të pandehurin për marrje në pyetje, por i njëjti me shkresë të datës 08.08.2012 kërkoi nga kjo gjykatë të dëgjohej në gjykatën përkatëse në Gjakovë, meqë jeton dhe punon në Gjakovë. Por, ndonëse lënda është dërguar në gjykatë në Gjakovë, e njëjta është kthyer me datë 18.03.2013 pa u dëgjuar fare i pandehuri, andaj kjo gjykatë sërish ka ftuar të pandehurin, i cili në mbrojtjen e vet theksoi se, vërtetë nuk e ka bërë deklarin e rregullt të pasurisë deri më datë 31.03.2012, për arsye se nuk ka qenë në dijeni se, si anëtar i jashtëm i KPK i deleguar nga Oda e Avokatëve, ka pasur obligim për të deklaruar pasurinë, meqë askush përfshirë edhe menaxherin nga zyra e burimeve njerëzore Sadri Krasniqi, nuk e kishte njoftuar. Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike gjyqtarja dëgjoi edhe zyrtaren nga zyra e burimeve njerëzore e Prokurorisë së Shtetit, Violetë Neziri, në cilësi të dëshmitares, e cila deklaroi se vërtetë nuk i kishte njoftuar katër anëtarët e jashtëm të KPK, meqë kur personalisht ia kishte dërguar zyrtarit të AKK të quajtur Enis, listën e zyrtarëve të lartë publik të KPK ku ishin të përfshirë edhe katër antarët e jashtëm, e kishte pyetur nëse duhet apo jo t'i njoftojë edhe antarët e jashtëm, i njëjti i kishte thënë “merremi ne me ta”. Përndryshe siç thotë zyrtarja kontaktuese, sikur që i kishte njoftuar zyrtarët tjerë nga Prokuaroria e Shtetit, do t'i njoftonte edhe katër antarët e jashtëm. Paraprakisht gjyqtarja kishte dëgjuar edhe zyrtarin e AKK Enis Sadiku, në cilësi të dëshmitarit, i cili kishte deklaruar se të gjithë antarët e KPK të brendshëm apo të jashtëm kanë status, kompetencë dhe obligime të njëjta për deklarim të pasurisë. Gjykata nuk është lëshuar në vërtetimin e faktit nëse zyrtari i AKK i kishte thënë zyrtares kontaktuese se AKK do të merret me antarët e jashtëm, ngase konstatimi i tillë nuk e ndërron gjendjen faktike, meqë zyrtarja kontaktuese pranoi se vërtetë nuk i kishte njoftuar anëtarët e jashtëm të KPK.

05-1316/13/0-
sk-09


Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, dëgjimi i dëshmitarëve dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, se i pandehuri nuk mbanë përgjegjësi kundërvajtëse meqë nuk ka qenë i informuar nga zyrtarja kontaktuese për obligimin e deklaramit të rregullt të pasurisë deri më datë 31.03.2012, andaj komfor nenit 198 parag.1 pika 8 të LK ndaj të njëjtit e pezulloi procedurën kundërvajtëse në mungesë të provave.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES

Nr.regj.24122/2012, datë 04.04.2013

Sekretare Juridike
Gylten Dubovci



Gjyqtare
Suzana Cerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e paktënar ka të drejtë të ushtrojë ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.